

ASIM EFENDI LUZHA - SINERGJIA E FESË ME ATDHEUN

(Alban Dobruna, *Asim Luzha*, Instituti i Historisë
“Ali Hadri”, Prishtinë 2025)

Në historinë e popullit shqiptar, përmasat e heronjve shpirtërorë dhe prijësve kombëtarë shpesh kanë mbetur të paqarta për shkak të rrethanave historike, të pushtimeve të njëpasnjëshme dhe të mungesës së institucioneve shkencore që të merreshin me evidentimin e figurave lokale. Një nga këta personalitete, që për dekada të tëra qëndroi në hijen e kujtesës, është Asim Efendi Luzha, klerik mysliman, predikues i fesë dhe udhëheqës shpirtëror e kombëtar në trevat e Kosovës gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.

Ky material, i hartuar me kujdes dhe përkushtim, ka synim ta nxjerrë figurën e tij nga harresa, duke ia rikthyer vendin që meriton në historinë e qëndresës shqiptare. Ai përbën jo vetëm një studim historik, por edhe një dëshmi të gjallë të asaj se si feja dhe atdhetaria, në duart e njerëzve me vizion, mund të shndërrohen në ura që mbajnë gjallë identitetin kombëtar. Qëllimi i këtij studimi është i dyfishtë: nga njëra anë, të paraqesë biografinë e Asim Efendiut në mënyrë kronologjike, duke përshkruar origjinën, rininë, arsimimin dhe veprimtarinë e tij fetare; nga ana tjetër, të nxjerrë në pah kontributin e tij në mbrojtjen e interesave kombëtare dhe në forcimin e vetëdijes shqiptare në një kohë të vështirë, kur Kosova po kalonte nën zgjedhën e pushtimit serb. Në këtë mënyrë, materiali synon të tregojë se personalitete si Asim Luzha nuk janë thjesht figura fetare, por edhe gurë themeli të qëndresës kombëtare dhe morale të shqiptarëve.

Autori është mbështetur në një shumësi burimesh. Janë përdorur dëshmi arkivore, kujtime të familjarëve dhe të bashkëkohësve, si dhe referenca nga literatura historike dhe publicistike. Po ashtu, një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe kujtesa kolektive e komunitetit, e cila e ka ruajtur figurën e Asim Efendiut si prijës shpirtëror.

Metodologjia e punimit është kryesisht përshkruese dhe interpretative: paraqiten ngjarjet kryesore të jetës së tij dhe shoqërohen me komente që nxjerrin në pah përmasën e veprës së tij, duke e vendosur atë në kuadrin e historisë së Kosovës e të kombit shqiptar.

Autori punimin e tij e ka ndarë në tetë pjesë, duke ndjekur renditjen kronologjike dhe tematike. Punimi nis me kapitullin Hyrës: Aty figura e Asim Efendi Luzhës shfaqet si një ndër më të shquarit prijës fetarë e patriotë të Kosovës së gjysmës së parë të shekullit XX. Ai mishëroi në mënyrë të harmonishme përkushtimin ndaj fesë islame me idealin kombëtar shqiptar, duke u bërë shembull i rrallë i bashkimit të dy botëve që shpesh shiheshin në kundërshtim.

Qëllimi i këtij punimi nga ana e autorit, është të ndriçojë jetën, veprën dhe trashëgiminë e tij në një këndvështrim sa më të plotë. Përmbajtja e monografisë shtrihet mbi disa shtylla themelore:

Origjina dhe fëmijëria: Asim Efendi Luzha u lind në një familje të njohur të Kosovës, ku u edukua në frymën e fesë dhe të dashurisë për atdheun. Prejardhja e tij familjare me rrënjë të forta në traditat e besimit dhe të atdhedashurisë, ndikoi thellësisht në formimin e karakterit të tij. Rrethanat në të cilat u rrit ushqyen tek ai bindjen se liria dhe feja nuk ishin të ndara, por ishin dy shtylla të pandashme të ekzistencës.

Arsimimi dhe formimi: Ai ndoqi shkollimet fetare dhe u bë një njohës i thellë i traditës islame, duke fituar reputacion si predikues i respektuar. Autori trajton arsimimin dhe formimin e tij intelektual ku ndalet veçanërisht në rrugëtimi i tij arsimor i cili ishte përqendruar në mësimet fetare, duke mos e kufizuar horizontin e vet ky personalitet vetëm në to. Ai përthithi dije të gjera nga kultura islame dhe ajo perëndimore, duke i bërë bashkë në një vizion unik për shoqërinë shqiptare. Kjo përzierje e dijes e përgatiti për të qenë jo vetëm klerik, por edhe udhërrëfyes i shoqërisë.

Veprimtaria fetare: Si imam dhe udhëheqës shpirtëror, ai shfrytëzoi xhaminë jo vetëm si vend faljeje, por edhe si qendër bashkimi kombëtar, ku shqiptarët gjenin forcë dhe shpresë përballë pushtimit. Si imam e prijës fetar, Asim Efendi Luzha u dallua për aftësinë e tij për të afruar njerëzit me fenë si sistem vlerash morale, arsimuese e shoqërore. Për të, Islami nuk ishte një kornizë e ngurtë ritualesh, por një udhërrëfyes gjithëpërfshirës, i cili frymëzonte drejtësi, solidaritet dhe dashuri për atdheun. Ai arriti të ndërthurte dimensionin fetar me misionin shoqëror, duke shmangur çdo formë të keqin-terpretimit fetar.

Roli politik e kombëtar: Në periudhën e pas shpalljes së Pavarësisë dhe sidomos pas pushtimit serb, Asim Efendi Luzha doli në krah të popullit të vet, duke predikuar qëndresë, unitet dhe dashuri për atdheun. Ai nuk u mjaftua me detyrën e klerikut, por u bë udhëheqës i mendimit kombëtar në zonën e tij.

Asim Efendi Luzha ishte veprimtar aktiv dhe luajti rol në ndihmë të dy organizatave: Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe Xhem'ijetit.

Asim Efendi Luzha u shqua për një angazhim të jashtëzakonshëm në dy fronte të rëndësishme të mbrojtjes së kombit shqiptar. Në Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, ai ishte një nga drejtuesit kryesorë që organizoi qëndresën e shqiptarëve kundër politikave shfarosëse të serbëve, duke kthyer xhamitë në qendra edukimi dhe identiteti kombëtar, ndërmjetësuar degët e tjera të organizatës dhe mbledhur me kujdes statistika, promemorie e informacione për të avancuar çështjen kombëtare.

Në organizatën “Xhemijeti”, Luzha luajti rol kyç në forcimin e rrugës ligjore të shqiptarëve myslimanë, duke kontribuar në zgjedhjet e brendshme, promovimin e liderëve patriotë dhe pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve, duke siguruar që feja islame të shërbente si urë lidhëse mes aspiratave fetare dhe atdhetare. Përmes këtyre veprimeve, Asim Efendiu tregoi se përkushtimi ndaj fesë dhe dashuria për kombin mund të bashkëjetojnë dhe të fuqizojnë njëri-tjetrin.

Ky studim ka disa vlera të dukshme: Së pari, sjell në qendër të vëmendjes një figurë të panjohur ose pak të njohur. *Së dyti*, tregon se feja islame, në duart e udhëheqësve të ndritur, ishte një shtyllë e rëndësishme për ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar. *Së treti*, ndërthur dëshmitë e shkruara me ato gojore, duke krijuar një pasqyrë të gjallë dhe të afërt me realitetin. *Së fundmi*, risia qëndron në faktin se Asim Efendi Luzha nuk shihet thjesht si imam, por si udhëheqës i një bashkësie që kërkonte rrugëdalje nga robëria, duke e bërë atë figurë me rëndësi historike dhe kombëtare.

Figura e Asim Efendi Luzhës është dëshmi e gjallë se si në historinë shqiptare feja dhe atdheu nuk kanë qenë të ndara, por shpeshherë të bashkuara në një trup të vetëm. Ky studim arrin ta nxjerrë nga harresa dhe ta vendosë pranë figurave më të shquara të Kosovës. Me një gjuhë të qartë dhe me mbështetje në burime të shumta, ai i ofron lexuesit jo vetëm njohjen me një klerik të përkushtuar, por edhe me një pishtar të qëndresës kombëtare. Në këtë kuptim, vepra është një kontribut i çmuar për historinë, kujtesën dhe identitetin shqiptar.

Si përfundim, mund të themi që autori ka arritur ta vlerësojë figurën e Asim Efendi Luzhës duke e vendosur atë në plejadën e kujtesës popullore dhe historike, ku patrioti Asim Efendi Luzha radhitet përkrah figurave të mëdha të Kosovës e më gjerë: Gjon Nikollë Kazazit, Tahir Efendi Gjakovës, Bajram Currit, Aqif Blytës, Shaban Polluzhës e shumë të tjerëve.

Vlerësimi i tij lidhet me aftësinë për të qenë njëherësh klerik i devotshëm, patriot i palëkundur dhe udhërrëfyes shpirtëror e shoqëror. Kjo e bën atë figurë të denjë për t'u përmendur në çdo kapitull të historisë kombëtare.

Shekulli XX për shqiptarët e Kosovës ishte periudhë e trazuar, mes perandorive që shembeshin dhe shteteve të reja që ngriheshin mbi tokat e tyre. Në këtë vorbull, figura të tilla si Asim Efendi Luzha u bënë dritare shprese, duke ruajtur identitetin kombëtar e fetar përballë presioneve të shumta.

Përmes aktivitetit të tij, ai dëshmoi se kultura dhe feja mund të jenë ura lidhëse, e jo ndarje mes shqiptarëve. Si përfundim, mund të themi se: Përkushtimi i tij ndaj çështjes kombëtare ishte i pandarë nga ai fetar.

Ai ishte ndër ata që dëshmuar se feja islame nuk përbënte pengesë për shqiptarinë, por një burim të fuqishëm frymëzimi. Shembulli i tij dëshmon atë që pati pohuar edhe Thimi Mitko: se myslimanët shqiptarë ishin ndër patriotët më të mirë. Kjo bëri që Asim Efendi të fitojë respektin e gjerë si ndër prijësit më të ndritur të kohës.

Figura e Asim Efendi Luzhës mbetet një simbol i bashkimit ndërmjet fesë dhe atdheut, duke dëshmuar se përkushtimi shpirtëror dhe dashuria për kombin nuk e përjashtojnë, por e plotësojnë njëra-tjetrën. Shembulli i tij është dëshmi e një kohe, kur burrat e Kosovës dhe gjithë Shqipërisë ditën të sakrifikonin për lirinë, duke e gërshetuar fenë me patriotizmin. Ai mbetet një model frymëzimi për brezat që kërkojnë ta shohin fenë dhe kombin si shtylla të së njëjtës shtëpi.

Ilirjana KACELI - DEMIRLIKA